# DËSHMI ARKIVI

**A-462212**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Dyzimi i Edi Ramës/ Edhe e falenderon Vlora Hysenin edhe e “shplan” qeverinë nga mëkatet e saj |
| ADRESA | `https://lapsi.al/dyzimi-i-edi-rames-edhe-e-falenderon-vlora-hysenin-edhe-e-shplan-qeverine-nga-mekatet-e-saj-i1094231` |
| BURIMI | lapsi.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 05:36:01 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 22 shtator 2026, 14:56:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d9b6862cb871fa0291345a897873fe8b6ba70672ca23ca9100bc2d2f5d819585` |
| TEKSTI | `ee59efef696b0c3299e30cd9611e5f843fec45408a3f0e474aa01d3c5cb5b486` |
| PAMJA | `7e1d070ae6d74360668ab1ce1d3d118a50ebc9668e47acffebc05d2e9d8d9c43` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `0d600f90075bd73730256be1cfbcf9bbc143bd57659485843b623bfa2908cd3e` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `9a62bc48d128c347cbec1d2f32b4c754e5d530aa01fd4a64b6b1015f32f32417` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/0d600f90075bd73730256be1cfbcf9bbc143bd57659485843b623bfa2908cd3e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Dyzimi i Edi Ramës/ Edhe e falenderon Vlora Hysenin edhe e "shplan" qeverinë nga mëkatet e saj

Cili qe mesazhi i kryeministrit? Përpjekja e pamundur për të imponuar alibinë se nuk njolloset qeverisja

LAPSI.AL • 22 SEPTEMBER 2026



Masa e arrestit të SPAK ndaj shefes së SHISH e ka futur në ngërç kryeministrin Rama deri në atë pikë sa ai të heshtë për më shumë se shtatë orë që pas bërjes publike të lajmit për Vlora Hysenin.

Vetë kreu i qeverisë është justifikuar me ndryshimin orareve mes Tiranës dhe New Yorkut, ku ai gjendtet momentalisht, në samitin e përvitshëm të OKB-së.

Por edhe nëse marrim të vërtetë lajmin se Rama nuk ka qenë i informuar që më parë, gjë që zor se mund të ndodhi me një kryeministër që e ka si emërtesë të vetëm kokën e organit kyç të sigurisë kombëtare, në rastin më të mirë, për një urgjencë si kjo, kryeministrin stafi e zgjon dhe nga gjumi. Pra ndryshimi i fashave orare me gjasë është thjeshtë një alibi e dobët.

Lexo më tej



22 SHTATOR, 14:48
Rënia e Vlorës në shtratin e krimit

Atëhere çfarë e bëri Ramën të ngurojë?

Më mirë se nga çdo gjë tjetër kjo kuptohet nga gjuha e dyfishtë që ai përdori kur vendosi të flasë. Kjo mënyrë tipike e shprehjes, që ai e përdor sa herë gjendet në hall, edhe e ngre lart shefen e SHISH edhe vëren se përgjegjësitë e saj janë personale. Në deklaratën e vonuar të Ramës shprehet mirënjohje dhe "respekt për punën dhe për

ide



Rënia e Vlorës në shtratin e krimit
Armand Shkullaku



Haga, si përfundim i një epoke të gjatë yes man-izmi
Andi Bushati

MOTI TIRANA 17°C
KËMBIMI EURO 91.40

aktuale

08:20
Protesta nuk ndalet, qytetarët rikthehen sot para Kryeministrisë: Rama jep dorëheqjen

19:41



"Nuk shitet Shqipëria, shitet qeveria", 114 ditë revoltë kundër qeverisë në bulevard

PROMO



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në

Me interes nga publiku

personin e Vlora Hysenit", nuk harrohet të thuhet shprehja se "unë i jam falenderues Vlora Hysenit për çdo gjë që ka bërë si duhet në shërbim të Shqipërisë", dhe së fundi, aspak në mënyrë të pafajshme theksohen "vlerësimet e vazhdueshme, që ajo ka marrë nga agjencitë partnere si drejtuese e shërbimit inteligjent shqiptar".

Lexo më tej



22 SHTATOR, 15:39

**Rama shkarkon Vlora Hysenin**

Por përtej këtyre furçave, në deklaratë përpos karrotës bie në sy dhe shkopi. Rama njofton se do ta shkarkojë dhe do t'i gjejë menjëherë zëvendësin sapo të kthehet në atdhe. Ai gjithashtu kujdeset të theksojë se ajo nuk do të merret në mbrojte, sepse nëse ka përgjegjësi ato janë personale.

Pikërisht brendda këtij dyzimi kuptohet edhe pse Rama nguroi aq gjatë për të reaguar. Nga njëra anë, atë e bren meraku se nuk mund të njësohet në publik me dikë që ka nxjerrë sekretin shtetëror dhe ka ndihmuar personazhe të krimit. Ama nga ana tjetër, ai është i ndërgjegjshëm se posti që Hyseni ka mbajtur e bën atë të ketë në duar shumë sekrete edhe për pushtetin e Ramës. Prandaj dhe asaj i duhet shkelur një sy.

Nga ana tjetër Rama bën ç'është e mundur që të shplajë topin e fundëm të baltës nga fytyra e njollosur e kësaj qeverisjeje. Ai e di se Vlora Hyseni ra në shtratin e bandës së Ergys Agasit, se për të ka video dhe mesazhe, se ajo ka ushqyer me info bandën kriminale. Ai ia di edhe historinë se pse u shkarkua nga shërbimi informativ i Kosovës dhe se si e paralajmëroi kryeministri Kurti, që mos nxirrte në pazar sekretet e shtetit. Por pavarësisht nga këto në 2022 Rama e vendosi në krye të SHISH-it. Se për çfarë shërbeu aty tani të gjithë e dinë.

Lexo më tej



22 SHTATOR, 12:07

**Tërmet në kupolën e sigurisë/ Arrest shtëpie për Vlora Hysenin, Ilir Proda në SPAK**

Por pikërisht më këtë përshtypje të përgjithshme reket të luftojë kryeministri. Kryefjala e tij është: Ajo që ka ndodhur sot nuk njollos këtë shumicë qeverisëse. Për të qenë bindës në këtë mision të pamundur ai ka përdorur tre truke të superkonsumuara.

**Së pari** ka duke barabitur veten me Shqipërinë është munduar të argumentojë se kjo ngjarje "As mund të jetë baltë kundër Shqipërisë, e cila po bën në rrugën e saj të bashkimit me Europën shumëçka që as nuk mund të imagjinohet".

**Së dyti** duke u munduar të shfryjë habinë dhe zhurmën e një zbulimi të tillë që "grin mish njeriu në mexhelisin politik e mediatik dhe për të thirrur "litarin" si në sheshet e ekzekutimit mesjetar, kohë përpara sesa gjykata të thotë fjalën e saj.

**Dhe së treti** duke përsëritur se në fund të fundit është shumica socialiste që ia ka krijuar këto hapsira drejtësisë.

Lexo më tej



22 SHTATOR, 16:25

**Ambasada amerikane mesazh për sigurinë, pasi u shpall në kërkim drejtuesja e SHISH**

Por pavarësisht këtyre piruetave, fleta e arrestit për shefen e shërbimit, pasi i janë akuzuar si hajdutë dy zëvendësa, pasi i ka rënë brenda kreu i bashkisë më të madhe në vend dhe disa ministra, aq më tepër që Vlora Hyseni po akuzohet se së bashku me ish drejtorin e përgjithshëm të Policisë i kishin vënë në shërbim të bandave kriminale institucionet e tyre, e njollos keqazi këtë pushtet autokratik. Prandaj shfajësimi se këto nuk janë aktakuzë për qeverinë që Ramës iu desh mbi shtatë orë ta shqiptonte duket më qesharak se kurrë.




**Aplikacioni për komunikime sekrete/ Si flet Belinda Balluku me Skënder Hitën (VIDEO)**




SPAK lëshon masë sigurie për kreun e SHISH/ Vlora Hyseni pezullohet nga detyra




SPAK reagon zyrtarisht për "arrestin" e shefes së SHISH




Berisha nxjerr VIDEON/ Pjerin Ndreu u përplas me shqiptarët e takimit të Ramës në Michigan

LAPSI.AL

## Të këshilluara



### Qeveria u kërkoi fitimin e fshehur/ Pse e refuzuan Ramën tregtarët e ushqimeve

Nga Dorian Kodra Të premten në mesditë, në një nga sallat e kryeministrisë ishin ftuar pronarët e supermarketeve, që pr...




### Saranda nën terror/ Drejtori i policisë në Rinas, si figurant në videon e ministrit të ri

Vrasja e Artan Myrtajt paraditen e këtij të diele në qendër të Sarandës është pjesë e një konflikti të n...



### Bilanci i presidencës Begaj/ Gjenerali që u shkri si sheqeri



### Gjykata ndërkombëtare bllokon qeverinë Rama/ Pse nuk ndërhyn SPAK për aeroportin e Vlorës

Urdhri i arbitrit të ICC-së frenoi qeverinë nga krijimi i një fakti të kryer në Aeroportin e Vlorës, duke mbrojtur përkohësisht jo vetëm interesat e MABCO-s, por edhe buxhetin shqiptar nga rreziku i një arbitrazhi me faturë prej qindra milionë eurosh.



### Revolta në Prishtinë, kënaqësi në Beograd/ Si u prit dënimi me burg për ish-krerët e UÇK-së

Vendimi i Gjykatës Speciale për të dënuar me gjithsej 81 vite burg katër ish-drejtuesit kryesorë të Ushtrisë Çli...



### Nga torturat te vrasja e 96 personave/ Pse i dënoi Haga katër ish-krerët e UÇK-së

Gjykata Speciale dënoi Hashim Thaçin dhe Jakup Krasniqin me nga 25 vjet burg, Kadri Veselin me 18 dhe Rexhep Selimin me 13, pasi i shpalli fajtorë për ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje si krime lufte, ndërsa rrëzoi akuzat ndaj tyre për krime kundër njerëzimit.






## Trafiku i drogës, korrupsioni dhe projekti i Kushner, seancë dëgjimore në Kongresin amerikan, DASH mbështet SPAK



### "Diplomacia e dollarit" vjen në Shqipëri/ The New Yorker: Si u hapën dyert për Kushnerin

Jared Kushner me dorën e djathtë bën diplomaci, me të majtën bën biznes. Shqipërinë e kap me dorën e majtë.



### Veliaj mbetet në burg/ Gjykata e Lartë e sheh si proporcional izolimin e tij?

Çdo të bëhet me qytetarët e Tiranës tani që psi për arsye të procesit Veliaj e futi Bashkinë në kaos. A do të vijojë të këmbëngulë ai që mos e delegojë sërisht atutoritetin dhe firmën dhe të shtiret si kryetar nga burgu?




### Zgjerohet skandali i izraelitit Ron Yeffet, përgjimi: Shkoni në Vlorë dhe bëni çfarë të doni"

"Shkoni në Vlorë dhe shikoni, bëni çfarë të doni, më pas do të merrem unë me ta" është fja...

## Me sytë katër



20:52

### PAMJET/ Nis papritur bora në bjeshkët e Deçanit

Mediat në Kosovë kanë publikuar pamje të reshjeve të dëborës që kanë filluar këtë të martë n&e...



Dy VIDEO-t/ Si e paralajmëroi Gaz Bardhi lidhjen Gys Agasi-Vlora Hyseni

16:12



E RRALLE/ Trump del në TV pa zë për shkak të bojkotit të mediave

22:10



Berisha nxjerr VIDEON/ Pjerin Ndreu u përplas me shqiptarët e takimit të Ramës në Michigan

21:02



Pamjet/ Sherr me shkopinj mes lojtarëve të rinj të hokejit në akull

20:20




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.